

RECITALI I VIOLINISTIT FLORIAN VLASHI NJE DOKUMENT ZANOR DHE PAMOR I INTERPRETIMIT TE NJE MUZIKE TE RE

Nga
Conf, univ. Dr.
LUMINICA VIRGINIA BURCA

Universale dhe e gjithekoreshme, dmth. gjithmone “moderne”, muzika eshte me e larta e nje stili lirik te kristalizuar ne kohe brenda nje ene universale. Muzikanti – historian eksplorues e kerkues, “ditar i vertete i anijes” – perpiqet te t’u zbuloj te dashurve te Euterpes, esencat tingullore qe ende nuk jane deshifruar teresisht.

Brenda kuadrit natyror te pranveres dhe ne vendet kulturore te Bukureshtit, kam vene re se muaji i fresket i prillit, ka qene plot koncerete dhe recitale te ndertuar me saktesi qofte nga pikepamja muzikore ashtu edhe nga personalitetet e shquara artistike “sikur te ishin nje idiomatike e dyte” muzikore.

Nje nga keto qe recitali per violine solo me 5 prill te 2013 ne oren 19.30 Per ata qe ishin te interesuar te njohin personalitetin e artistit, paten rastin ta shihnin ne skenen e famshme George Enesku te Universitetit Kombetar te Muzikes ne Bukuresht violinistin Florian Vlashi.

I ftuar nga violinistja Con. Univ. Dr. Luminica Virginia Burca, ne Unuversitetin Kombetar te Muzikes ne Bukuresht, Florian Vlashi, me origjine shqiptare, anetar i OSG ne Korunja – Spanje dhe drejtues i “Grupo Instrumental Siglo XX”, ka krijuar nje moment unik dhe njeheresh dritherues. Recitali kishte dale nga e zakonshmjë nga menyra se si violinisti kishte ndertuar permbajtjen e koncertit duke u mbeshtetur ne tema shume interesante si Homazh Shagalit me vepren e tij “Violinisti i gjelbert “

Para se te niste te luante, Vlashi shprehu me fjale krijimin e Mark Shagalit, nje piktor modern me origjine hebraike i lindur ne Bjellorusi, emigrant ne Gjermani e pastaj ne France. Stili i tij konsiderohet origjinal, ngushtesish i lidhur me kulturen hebraike, me nje stil poetik nen ndikimin e fantazise dhe melankonise. Ne tabllote e tia ndeshim shpesh violinista qe luajne, violinista qe ai kujton se i kishte degjuar ne ngjarje te ndryshme te feminise.

Florian Vlashi nenvizoi lidhjen ne mes te violinistave ne pergjithsi dhe piktorit Shagal. Kjo gje e shtyri artistin te interpretonte nje repertor bashkekohor kushtuar piktorit framcez.

Solisti qe ka pervoje te madhe ne interpretimin e kesaj muzike te re, zgjodhi nje repertor qe i perket shekullit te XX dhe XXI me vepra pak te njohura ne Romani, madje edhe nje debut boteror. Kompozitoret e zgjedhur qene keta: Karmella Tcepkolenko, Cezar Aliaj (shqiptar qe paraqiti vepren e vet frymezuar nga pikurat e Shagakit), Maurice Ravel, Iannis Xanakis, dhe Alfred Shnitke. I ftuari yne kishte caktuar qe çdo vepre qe luhej t 'i perggjigjej nje tablo e Shagalit qe projektohej ne ekranin e madh.

Tingulli, fjala, ngjyra, si nje ekologji shpirterore, mishrohet ne nje ngjarje ku muzika e figura i kundervihen njera tjetres si diçka qe vjen nga pertej reales. Duke hapur portat e shpirtit adhuruesit e ndryshem te muzikes kane zbuluar tingullin e shkelqyeshem te muzikantit te ardhur nga Spanja.

Artisti Florian Vlashi me nje edukim te larte instrumental e muizikor te vendit te tij Shqipërise, e rrembeu publikun e perbere nga muzikologe, violinista te rinj, pikture, shkrimitare etj me nje tekniqe te pagabueshme dhe bukuria tingullore nga te cilat dilte ne pah talenti i tij , te dhenat dhe poashtu edhe mesazhi i kompozitorit. Arti i tij interpretativ spikaste fale njohjes se thelle te kesaj muzike te re. Duke rreshqitur doren mbi tastieren e violines ai zbuloi gjithe aftesine krijuese kromatike e cila kodifikohej ne vvetete,

Veprat e interpretuara ishin shume te veshtira me nje tekniqe violinistike komplekse, me picikato te forte, me glisando ne kordat e dyfishta, trile, ricochet e keshtu me rradhe, pa melodi, e mbeshtetur vetem tek ritmi dhe efektet e shumte tingullor.

Zoterimi i vvetetes, siguria e kontrolli i harkut lane mbresa te medha tek publiku. Vetem keshtu mund te kuptohen frutet qe arriti te marre. Gjate koncertit, Floriani deshmoi se meditonite me pasion mbi misterin e muzikes Te vleresosh nje violinist me aq hir lirik eshte detyre e çdo artisti ndaj nje artisti tjeter.

Nga menyra si e perballonte muziken ai shprehu rendesine qe artisti i jep nje bote te zbuluar nga nje kendveshtrim tjeter, me te lire, me te hapur se sa ai qe praktikohet zakonisht. Shpirti i tij i kultivuar dhe drejtbeschimi i brendshem, zbuloi nje talent te forte, te afte per te kuptuar boten e muzikes se re, si dhe rrugen e domosdoshme ne artin interpretativ modern. Gjithe edukimi violinistik dhe estetik qe ai shprehu shfaqi nje univers muzikor te fresket pa aluduar per zjarre pasionale.

Ne mes te koncertit u krijuua diçka e veçante, nje intermexo nga baritonin Radu Ion i cili po kryen masterin ne universitetin e Bukureshtit dhe pianistes Cesara Petresku profesore ne po ate institucion. Na kenaqen melodite e George Enescut, Valentin Timaru e Paskal Bwntoiu (kompozitore rumune te she, te XX) qe u interpretuan me ndjeshmeri e me nje trajtim te veçante, diçka e re per interpretimin e muzikes bashkekohore.

Recitali u mbyll me nje veper te veshtire per violin solo te Alfred Schnittke "Paganinit" tek e cila mund te shquheshin qelizat ritmike origjinale te disave prej kapriçove te Paganinit: nr. 1,5,9,13,17,21. etj.

Recitali per violin solo ne teresine e vet qe nje dokument tingullor e pamor i muzikes se re. Koncerti i konceptuar si homazh Shagalit, e ngriti shpirtin e spektatorit ne nevelin me te larte.

Emocioni qe perfoton nje trajtim i tille sherben per t 'u mesuar dashamiresve te muzikes qe te jene te hapur, te shtrojne probleme dhe te mesojne sa me pare mos te jene indiferente ndaj "zhurmave" te jetes.

Talenti artistik i Vlashit u shqua ne mes te tjerave nga autenticiteti i shprehjes sepse ai shfaq nje ndjeshmeri te brendshme, te holle qe evidenton sinkronizmin e arteve qe bashkon tingujt imazhet dhe fjalet ne fibra fantastike per te ndertuar ide te jashtzakonshme.

Duke vrojtuar dhe rjetuar kete event unik artistik, koncertin e Florian Vlashit, qe u zhvillua ne "Katedralen e tingullit", une e kuptoj si nje udherrefyes dhe nje bashkepunim artistik i epert i ardhur nga vende e kultura te ndryshme per te cilat kemi aq nevoje..

E shkruajta kete artikull kushtuar artistit qe interpretoi ne ate dekor emblematik duke dashur qe te ruaj per gjithmone kete thesar te vyer njerezor dhe per t 'u siguruar se nuk do te harrohet kurre.

Bukuresht. prill 2013 .